



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.99/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti Kryesues, Kujtim Pasuli, dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor-posterit në hapësirat publike në Istog, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë;09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;24.01.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa Anr.99/2025, e datës;21.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë;09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë;21.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë A.nr.99/2025, nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendon se Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Istog, ka identifikuar posterin e vendosur në hapësirat publike, konkretisht në rrethrotullimin në rrugën "Lidhja e Prizrenit", të kandidatëve për deputetë nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës LDK, Shkëmb Manaj dhe Besim Mulaj. Më tutje pretendojnë se me të njëjtin veprim subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së që parasheh: "*1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.* Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në

fjalë. Kërkojnë nga PZAP-i, që duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lart cekura, si dhe duke u bazuar tashmë në praktikën e PZAP-i, mes tjerash me vendimet Anr.48/2025, Anr.49/2025, Anr.50/2025, Anr.51/2025, masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, thekson se pretendimet e Lëvizjes Vetëvendosje në ankesën A.nr.99/2025, se Subjekti Politik LDK dhe disa prej kandidatëve për deputet nga Istogu me rastin e vendosjes së materialeve reklamuese-posterave, kanë shkelur nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme konsiderojmë se nuk qëndron ligjërisht. Sipas përgjigjes në ankesë theksohet se të gjitha rastet e vendosjes se këtyre materialeve-posterëve kemi të bëjmë me pëlqim të përkohshëm për shfrytëzim të hapësirës publike, të lëshuara nga Komuna e Istogut-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksohet se asnjë nga kufizimet e nenit 7 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, nuk ndërliidhen direkt apo indirekt me rastet në fjalë.

Përgjigjes në ankesë i është bashkangjitur Pëlqim i përkohshëm për shfrytëzimin të hapësirës publike, Nr.ref.11/351-1342/09, dhe Nr.ref.11/351-1562/11, e datës;20.01.2025, të lëshuara nga Komuna e Istogut-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit. Po ashtu në përgjigjen e subjektit politik LDK, është përfshirë rasti i subjektit politik LVV i cili nuk është dënuar, është Vendimi i PZAP-it Anr.74/2025 (vendosja e shtëpizës në sheshin Nëna Tereza për të cilën subjekti ka marrë leje në atë komunë), dhe po ashtu se ka leje/pëlqim nga Komuna e Istogut-Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirës publike. Kërkojnë nga PZAP-i, të marrë vendim meritore për rastin në fjalë duke u bazuar në krejt ato që u thanë që ankesa e subjektit LVV të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LVV, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit të Komunës së Istogut, të datës;21.01.2025, mbi shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike, për vendosjen e posterit në hapësirat/rrugët publike, vërtetoi faktin se vendosja e posterit nga kandidatë për deputet nga radhët e Subjektit Politik LDK, është në pajtim të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën e Zgjedhjeve, monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe

Deklarimit Financiar, përkatësisht, me nenin 5, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i cili nën përcakton se “1. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç përcaktohet në nenin 44 të LZP, subjektet politike të certifikuara kanë të drejtë: 1.2 Të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “3. Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimit Financiar, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr. 99/2025, datë;24.01.2025

Kryesuesi i Panelit
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.